



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**DOKUMENTI I RREGULLORES
PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR IMPIANTIN E PËRPUNIMIT TË
RËRAVË BITUMINOZE NË PATOS FSHAT FIER.**

**MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T**

Z. EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMENI
Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit

Z. DAMIAN GJIKNURI

Ministër i Energjitikës dhe Industrisë



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 5, Datë 03.12.2014

Projektues: Shoqëria "Edil Al" sh.p.k

TABELA E PËRMBAJ TJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES

1	Dispozita të Përgjithshme	3
1.1	Baza Ligjore	3
1.2	Përshkrim i zonës së studiuar	3
1.3	Përkufizimi i termave të përdorur	4
2	Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të nënruar në KKT).	4
2.1	Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV	4
2.2	Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit	4
2.3	Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim	4
3	Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)	5
3.1	Informacion për topografinë e zonës.	5
3.2	Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla).	5
3.3	Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike	6
3.4	Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj.	6
3.5	Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese.	6
4	Rregullat e Zhvillimit të Territorit	6
4.1	Funksionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave	6
4.2	Hapësira e zënë me ndërtesa.	7
4.3	Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave.	8
4.4	Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë.	10
4.5	Rregullat e zhvillimit.	11
4.6	Vendqëndrimi për automjetet.	11
5	Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës.	11
5.1	Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave	11
5.1.1	Rrjeti Rrugor	11
5.1.2	Rrjeti i furnizimit me energji elektrike.	11
5.1.3	Impianti i mbrojtjes kundër zjarrit	13
5.1.4	Impianti i shkarkimit të ujrave të zeza	13
5.1.5	Impianti i furnizimit me ujë	14
5.1.6	Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut	14
5.2	Hapësirat e lira dhe të gjelbërta	14
6	Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndërtimit	14
7	Relacionin e menaxhimit të inerteve të dala si rezultat i punimeve, që do të kryhen për realizimin e projektit.	15
8	Impaktet Kryesore në Mjedis	15
8.1	Impakt mbi sipërfaqen e tokës	15
8.2	Impakt mbi ujërat sipërfaqësore	15
8.3	Impakt mbi ujërat nëntokësore	15
8.4	Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)	16
8.5	Impakt mbi menaxhimin e tokës dhe mbetjeve	16
8.6	Impakt mbi Peizazhin	16
8.7	Impakt mbi Zhurmat dhe ajrin	16
8.8	Impakt mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë	16
9	Anekse (Hartet në format A3)	16

1 Dispozita të Përgjithshme

1.1 Baza Ligjore

Shoqëria "Brack Kappa Albania" shp.k., e regjistruar pranë QKR-së me NIPT L01915012A, me Adresë: Rruga Perlat Rexhepi, Godina - 13 katëshe, Kati I, Tiranë, me administrator Z. Mynyr Rexhepaj, ka si objekt aktiviteti: *"Shfrytëzimin, përpunimin dhe zhvillimin e lëndëve minerale, rërave vajore, si dhe të të gjitha llojeve të nënprodukteve të tyre, me qëllim shitjeje dhe rishitjeje, pas nxjerrjes dhe përpunimit të tyre, si dhe çdo aktivitet tjetër tregtar përfshirë këtu konçesionin, qiraje, etj, që do t'i shërbejë aktivitetit tregtar të shoqërisë"*.

Shoqëria Brack Kappa Albania në përputhje me ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, ka aplikuar në Ministrinë e Energjitikës dhe Industrisë me datë 30.09.2014 për ndërtimin e "Impiantit të Përpunimit të Rërave Bituminoze" në zonën minerare 802/3.

1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

Impianti i përpunimit të rërave bituminoze do të ndërtohet në afërsi të fshatit Patos-Fshat, Komuna Portëz, Rrethi Fier.

Vendndodhja e impiantit është identifikuar dhe finalizuar bazuar në një analizë të zgjeruar dhe vëzhgimeve në terren, nga ana e një ekipi inxhinierësh, gjeologësh ndërkombëtarë në bashkëpunim me ekspertë shqiptarë.



Kompania ka realizuar një studim të detajuar të aspektit rregullator të zonës së impiantit dhe ka konfirmuar përfshirjen e kësaj zone në Planin e Integruar Sektorial të Hidrokarbureve të miratuar në datë 10.05.2013.

1.3 Përkufizimi i termave të përdorur

Rëra Bituminoze - është rërë e shkrifët ose ranore, pjesërisht e konsoliduar, që përmban përzierje natyrale rëre, argjile dhe uji, të ngopura me naftë, teknikisht të referuara si bitum. Produkti i naftës mund të përdoret për të furnizuar rafineritë, ose për industrinë e Asfalt / Bitumit.

Impiant i përpunimit të rërave bituminoze – impiant që përdoret për të ndarë lëndën bituminoze nga rëra bituminoze dhe prodhimin e naftës bruto.

2 Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT).

Nga verifikimet e kryera, si dhe referuar faqes zyrtare të AKPT www.planifikimi.gov.al Bashkia Patos nuk ka një Instrument Planifikimi të miratuar.

2.1 Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV

Zona ku parashikohet zhvillimi nuk është e pajisur me Instrument Planifikimi, si rrjedhim nuk ka orientime dhe detyrime, të cilave ky zhvillim duhet ti përmbahet.

2.2 Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit

Duke qënë se zona ku parashikohet zhvillimi nuk është e pajisur me Instrument Planifikimi, nuk ka rregulla, norma dhe standarte zhvillimi, të cilat mund t'i referojmë në këtë dokument.

2.3 Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim

Duke qënë se zona ku parashikohet zhvillimi nuk është e pajisur me Instrument Planifikimi, nuk ka harta, të cilat mund t'i referojmë në këtë dokument.

3 Analiza e Gjëndjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)

3.1 Informacion për topografinë e zonës.

Zona e studiuar bën pjesë në njësinë kodrinore, me kuota që variojnë nga 160 m deri 210 - 250 m mbi nivelin e detit. Kjo zonë ndodhet në një shpat, i cili ka drejtim rënie veri deri veri-perëndimor dhe pjerrësi shpati mbi 15°-25°.



Pjerrësinë e shpatit e ka favorizuar prezenca e shkëmbinjve të butë, kryesisht të përbërë nga ndërthurja e shtresave argjilite - alevrolite dhe ranorë. Gjithashtu, përputhja midis drejtimit të rënies së shtresave gjeologjike të bazamentit mollasik, me drejtimin e rënies së shpatit, e ka favorizuar këtë kënd rënie të shpatit. Nëpër shpat vërehen disa proska sezonale, të cilat e presin sipas gjatësisë së tij shpatin duke ia prishur uniformitetin në drejtim të rënies. Pra, ky shpat ku kërkohet të kryhet ndërtimi është në përgjithësi i sheshtë dhe i copëtuar pak nga dukuria e erozionit.

3.2 Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla).

Zona e studiuar nuk është e pasur me IPV. Kjo zonë është tokë private dhe në të nuk ka burime ujore apo mjediset pyjore.

3.3 Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike

Zona në studim nuk është zonë e mbrojtur e çertifikuar nga Vërtetimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës dt 20.02.2013 Prot: 54/1. Gjatë fazës së ndërtimit do të ketë monitorim nga institucionet përgjegjëse të trashëgimisë kulturore.

3.4 Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj.

Në kushtet e një mungese të infrastrukturës në zonën e Impianit sipas vërtetimit nga Komuna Portëz date 04.03.2013 Prot: 64/1 është menduar që:

- ✓ Territori fabrikës do të lidhet me rrugën nacionale nëpërmjet një rruge të re prej rreth 2km, me seksion 2x3.5m + bankina 2x0.75 m. Është bërë kujdes që traseja e rrugës së re të kalojë larg qendrave të banuara.
- ✓ Përsa i përket infrastrukturës ndihmëse, kanalizimet e ujrave të zeza e të bardha do të përpunohen nëpërmjet gropave septike e një impianti trajtimi.
- ✓ Furnizimi me ujë do të kryhet nëpërmjet puseve, uji i të cilave do të trajtohet me një impiant pastrimi dhe filtrimi.

3.5 Lidhja me energjinë elektrike është parashikuar të kryhet nëpërmjet nënstacionit elektrik 35 Kv të Patosit, me linjë ajrore, në një distancë rreth 4 km nga fabrika. Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese.

Ndërtimi i impiantit të përpunimit të rërave bituminoze, përveç qëllimit kryesor të prodhimit të naftës, do të ndikojë pozitivisht edhe në realizimin e disa qëllimeve të tjera si:

- Përmirësimi i kushteve social-ekonomike të komunitetit të zonës;
- Punësimi direkt i banorëve të zonës si specialiste dhe punëtorë që nga faza e ndërtimit edhe gjatë shfrytëzimit të impiantit;
- Do të bëhet përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe rehabilitimi i saj;
- Punësimi indirekt nëpërmjet aktiviteteve dytësore që lidhen me veprimtari të tjera si sektori i shërbimeve, tregtisë, makinerive e paisjeve, etj.
- Përmirësimi i infrastrukturës vendore me rrugë, elektricitet, puse uji dhe përmirësim i kapacitetit vendor për emergjencat me brigadë zjarrëfiksësh, shërbime mjekësore, etj.
- Sistemim dhe trajtim i aspektit mjedisor.

4 Rregullat e Zhvillimit të Territorit

4.1 Funkcionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave

Proçeset teknologjike të impiantit zhvillohen në territore të hapura, të shpërndara sipas një skeme funksionale, e cila lehtëson aktivitetet e ndryshme të impiantit:

- **Zona e administratës** përmban brenda saj Godinën e Administratës, Laboratorit, Kontrollit dhe Rojes. Të gjitha këto në shërbim të mbarëvajtjes së punës në minierë. Gjithashtu në këtë zonë janë dhe ambientet ndihmëse për punonjësit e minierës.
- **Zona e nënstacionit elektrik**, përfshin Godinat e Nënstacionit Elektrik, kontrollit MCC dhe 2 Gjeneratorët e minierës.
- **Zona e impianteve**. Në këtë zonë do të jenë një sërë paisjesh të cilat do të përdoren për prodhimin e naftës nga rëra bituminoze. Zona e prodhimit të mineralit, përbëhet nga një sërë paisjesh dhe makinerish të cilat do të kryejnë ndarjen e mineralit nga sterili dhe do të kryejnë homogjenizimin e mineralit.
- **Zona e përpunimit të mineralit**. Zona e përpunimit të mineralit do të përbëhet nga një sërë paisjesh të ndryshme që do të bëjnë ndarjen e naftës nga rëra bituminoze.
- **Zona e depozitimit të mineralit**. Në këtë zonë do të bëhet depozitimi i mineralit që do të dërgohet më tej në linjën e përpunimit të rërës bituminoze.
- **Zonat ujëmbajtëse** janë zonat ku mbidhen ujrato e shiut
- **Zona e oxhakut të djegies së gazrave**, është zona ku është vendosur oxhaku nga i cili dalin gazrat e djegshëm.

4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa.

Sipas treguesve të zhvillimit të parcelës, koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim është 2.58 %, e përkthyer kjo në një sipërfaqe gjurme prej 2012 m², dhe një sipërfaqe totale ndërtimi prej 2882 m².

Këto ndërtesa ndihmojnë procesin e prodhimit, si dhe cilësinë e punës së punonjësve. Godinat janë shpërndarë në të gjithë territorin e vënë në dispozicion dhe zhvillohen në 8 tipologji të ndryshme.

- **Struktura Nr.1**, është Godina e nënstacionit elektrik dhe qendrës së kontrollit ka përmasa 30 x 17 m në plan, dhe ngrihet në lartësinë e dy kateve, duke çuar kështu sipërfaqen totale ndërtimore në 1020 m².
- **Struktura Nr.1a**, është një platformë betoni për gjeneratorin me përmasa 10x10 m në plan. Platforma ngrihet në lartësi 0.45 m.
- **Struktura Nr.2**, është Godina e administratës, kontrollit dhe laboratorit dhe rojes ka përmasa 30.4 x 12.4 m + 6.1 x 3.3 m në plan dhe ngrihet në lartësinë e një dhe dy kateve, duke çuar kështu sipërfaqen totale ndërtimore në 774 m².
- **Strukturat Nr.2a**, janë gropat septike për godinën e administratës dhe për laboratorin. Ato kanë përmasa në 10 x 10 m në plan, dhe zhvillohen nëntokë në thellësinë e 3m.
- **Struktura Nr.3**, është Godina e magazinës dhe e mirëmbajtjes ka përmasa 18 x 12 m në plan, dhe ngrihet në lartësinë e një kati.
- **Struktura Nr.4**, është Godina e rojes e cila përfshihet në strukturën 2, ka përmasa 6.1 x 3.3 m në plan, dhe ngrihet në lartësinë e një kati.
- **Struktura Nr.5**, është Godina e shërbimeve ndihmëse ka përmasa 36 x 12 m në plan, dhe ngrihet në lartësinë e një kati prej 7,4 m të lartë..

- **Struktura Nr.6,** është një platformë betoni për Depozitat dhe Pompat e ujit për MNZ me përmasa 30x10 m në plan. Platforma ngrihet në lartësi 0.45 m, dhe mbulohet me një strehë të lehtë për mbrojtjen nga shiu
- **Struktura Nr.7,** është Godina e gjeneratorëve të impiantit ka përmasa 12 x 12 m në plan, dhe ngrihet në lartësinë e një kati prej 7.2m të lartë.
- **Struktura Nr.8,** është Godina e operatorit e cila është kabinë portative me përmasa 6.5 x 4 m në plan, dhe ngrihet në lartësinë e një kati prej 3m.
- **Strukturat Nr.8a,** janë Tualete Portative që vendosen në 3 pozicione, të shpërndara nëpër fabrikë. Këto kanë përmasa në plan 1x1 m, dhe vendosen mbi platforma betoni.

4.3 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave.

Të gjitha ndërtimet karakterizohen nga një arkitekturë e ngjashme, për të patur të njëjtën linjë uniforme me një volumetri lehtësisht të perceptueshme.

Duke patur parasysh funksionin industrial të këtyre godinave, arkitektura është trajtuar e tillë, që të reflektojë këtë funksion. Përsa i përket lëvizjes së volumeve në arkitekturë, është projektuar që forma e volumet të diferencohet në ngjyra dhe materiale. Objektet krijojnë një siluetë dhe një pamje të rregullt dhe konform ndikimeve më të fundit të ndërtimeve të përngjashme në rajon dhe më gjerë.

Arkitektura do të jetë e thjeshtë, ndërthurje e pjesës civile me atë industriale, kjo për shkak të ndërthurjes së materialeve të përzgjedhura. Materialet e përzgjedhura për trajtimin e fasadës së ndërtesave do të jenë të ndryshme, duke u mbështetur në tipologjinë industriale.

Godina e administratës, Laboratorit dhe Rojes



Godina e magazinës dhe e mirëmbajtjes



Godina e shërbimeve ndihmëse



Më së shumti materialet e fasadave do të jenë kombinim i mureve të tullës të suvatuar, me panele sanduiç. Gjithashtu edhe mbulimi i godinave në disa raste bëhet me soletë beton-arme e në disa godina të tjera me panele sanduiç.



Ajo që i bën më funksionale këto ndërtesa është shkrirja e ndërtimit me natyrën nëpërmjet hapësirave të gjelbëruara duke ruajtur me fanatizëm natyrën përreth fabrikës. Të konceptuara në këtë formë ato trajtohen sipas të gjitha normave teknike bashkëkohore të ndërtimit.

Fabrika është menduar në të gjitha detajet për ta bërë sa më funksionale si në drejtimin industrial ashtu edhe në atë civil. Është menduar dhe projektuar për ambjente ndihmëse për personelin duke parashikuar salla ngrënie, relaksi dhe fjetina.

Fabrika do të plotësoj të gjitha nevojat dhe kërkesat e punonjësve duke patur përparsinë e të punuarit në një vend pa ndotje duke u kthyer në një vend pune të përshtatshëm sipas të gjitha kriterëve për ndërtime të tilla.

Në vetvete ky investim ruan dhe respekton natyrën si edhe i rrit vlerat urbane zonës së marrë në studim.

Nga pikpamja arkitektonike dhe konstuktive ndërtimet do t'i përmbahen të gjitha standarteve bashkëkohore, ku përfshihen: ngrohja qendrore për çdo ndërtesë, punime, materiale dhe pajisje cilësore, dritare dopio xham, mure të izoluar.

4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë.

Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	78,000 m ²
Sipërfaqe e truallit që përdoret për zhvillim:	60,000 m ²
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):	2012 m ²
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit:	2,882 m ²
Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim:	2.58 %
Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për rrugë:	17.1 %
Intensiteti i ndërtimit:	0.037

Lartësia maksimale e strukturës:	variabël 3,9 - 8,6 m
Numri i kateve mbi tokë:	1 dhe 2 kate
Numri i kateve nën tokë:	0.5 kate

4.5 Rregullat e zhvillimit.

Zona në të cilën do të shtrihet impianti nuk ka IPV të miratuar në KKT.

4.6 Vendqëndrimi për automjetet.

Parkimi i makinave do të vendoset pranë zonës së administratës, që ndodhet në hyrje të fabrikës. Gjithashtu në hyrje të impiantit është menduar dhe një zonë parkimi për vizitorët prej 35 postesh, si dhe brenda fabrikës, në zonën e Administratës janë vendosur 7 parkime të jashtme.

5 Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës.

5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

5.1.1 Rrjeti Rrugor

Impianti do të lidhet me rrugën nacionale nëpërmjet një rruge të re të ndërtuar nga kompania. Kjo rrugë do të shtrihet në aksin e rrugës ekzistuese (e cila është një rrugë e pa asfaltuar). Kjo rrugë lidhëse dhe të tjera që do të ndërtohen, do të jenë një ndihmesë edhe për komunitetin e zonës, duke përmirësuar infrastrukturën e zonës.

Sistemi rrugor i brendshëm është menduar të ketë një skemë të thjeshtë dhe sa më efektive për një qarkullim të kontrolluar dhe të qetë.

Të gjitha rrugët respektojnë pjerrësitë e terrenit dhe ndërthuren natyrshëm me ndërtesat dhe ambientet e impiantit. Gjërësitë e rrugëve variojnë për rrugët kryesore e për rrugët e brendshme të impiantit, por gjithmonë duke ruajtur standartet për projektim të rrugëve. Gjithashtu nuk do të mungojë në impiant dhe sinjalistika e nevojshme e rrugëve.

5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike.

5.1.2.1 Furnizimi me energji elektrike.

Në kriteret e përcaktimit të skemës së furnizimit me energji elektrike (në rrjetin 35 kv) të këtij impianti janë marrë në konsideratë pozicioni gjeografik i zonës ku do të ndërtohet, planimetria e vendosjes së ndërtesave në bazë të zonave të ndërtimit, kërkesa e plotësimit të kushtit teknik të rënies së tensionit dhe plotësimi i kushteve teknike të ndërtimit të kabinave elektrike të cilat duhen të jenë sa më pranë qendrave të ngarkesave për konsumatet që do të furnizojnë.

Furnizimi me energji elektrike i këtij impianti, për vetë pozicionin që ka në lidhje me linjat e transmetimit të KESH-it është menduar të bëhet me linjë ajrore.

Linja që do shërbejë për furnizimin e impiantit është fideri, që del nga Nën-Stationi i Patosit. Distanca nga pika e lidhjes deri në kabinën më të afërt, që mendohet të ndërtohet (Kabina 1) është rreth 2.3 km, e cila plotëson kushtin teknik të rënies së tensionit në linjën 35 kv.

5.1.2.2 Përcaktimi i numrit të kabinave elektrike.

Përcaktimi i numrit të kabinave elektrike është bërë duke marrë parasysh numrin e përgjithshëm të ndërtesave dhe pozicionin gjeografik të vendosjes së tyre në planimetrinë e hartuar në bazë të atyre kritereve që u përmendën më lart, që kabina të jetë në qendër të ngarkesës elektrike për atë zone, që do të mbulojë dhe të plotësohen kushtet teknike të furnizimit me energji elektrike me tregues teknik optimal.

Është menduar të ndërtohen 2 (dy) kabina elektrike njëra nga të cilat (kabina 2) do të ketë dy transformatorë. Skema elektrike e kabinave do të jetë klasike, sipas skemës hyrje-dalje për të plotësuar kërkesat e lidhjes unazore të tyre.

5.1.2.3 Përcaktimi i fuqisë së transformatoreve.

Për përcaktimin e fuqisë së transformatorëve është marrë si bazë klasifikimi energjistik i objekteve (ndërtesave), që do të ndërtohen sipas fuqisë së vendosur. Për të gjitha ndërtimet është parashikuar, që përveç ndriçimit dhe ngrohjes së ujit sanitar me energji elektrike edhe ngrohja e ftohja e këtyre ambienteve do të bëhet me energji elektrike. Pra, është marrë rasti ekstrem i kërkesës për energji elektrike.

Çdo kabinë elektrike sipas skemës së shpërndarjes, që është menduar do të furnizojë me fuqi të instaluar me 24 këv për ndërtesat civile (zyra, ambiente shërbimi, etj). Koeficienti i njëkohshmërisë për këto objekte nisur nga natyra e tyre dhe specifikat e kërkesës së energjisë elektrike është marrë 0.26, pra çdo kabinë do të ketë një fuqi max rreth 530 këv dhe për të përballuar këtë ngarkesë në kabine duhet të vendoset një transformator me fuqi 630 kva.

Transformatori, që do të furnizojë me energji elektrike fabrikën e përpunimit është menduar të ketë fuqinë 2200 kva.

5.1.2.4 Rrjeti shpërndarës i TU 0.4 kv.

Për përcaktimin e skemës së rrjetit shpërndarës të TU janë marrë në konsideratë plotësimi i kërkesave të kushtit teknik të humbjes së lejuar të tensionit, jo më shumë se 4 % nga kabina deri tek konsumatori i fundit për regjimin e pikut të ngarkesës dhe kushti teknik i ngrohjes së përcjellësit. Për këtë është menduar që:

- Gjatësia e linjës dalëse të TU nga kabina të mos jetë më e madhe se 200 m.
- Ngarkesa max e linjës dalëse të mos jetë më e madhe se 250 A.

Furnizimi me energji elektrike i ndërtesave është menduar të bëhet nga bokset kolektive të matjes së energjisë elektrike të cilët do të vendosen në një hapësirë të caktuar të fabrikës dhe linja e furnizimit do të shtrihet nga dalja e matësit elektrik në Box direkt në kuadrin elektrik të çdo ndërtese. Linja e furnizimit e çdo ndërtese do të jetë 3 fazore.

Seksioni i përcjellësve për furnizimin e këtyre boxeve do të varet nga ngarkesa e tyre e që do të llogaritet në fazën e projekt-zbatimit. Ndërsa seksioni i kabllit të furnizimit të secilës

ndërtesë do të përcaktohet nga klasifikimi energjistik i tyre, pra nga fuqia e instaluar e secilës prej tyre.

5.1.2.5 Ndriçimi Rrugor

Furnizimi me energji elektrike i linjave të ndriçimit rrugor është menduar të bëhet nga të dy kabinat për të plotësuar kushtin e rënies së tensionit për zgjedhjen e seksioneve të kabllave të furnizimit.

Në çdo kabinë do të ketë dalje të veçantë me matje të energjise elektrike për furnizimin e ndriçimit rrugor.

Është menduar që në rrugët kryesore ndriçimi të bëhet me ndriçues pedonalë në të dy anët e rrugës. Ky ndriçim do t'i shtohet ndriçimit të jashtëm, që do të ketë perimetri i gardhit rrethues të fabrikës.

Gjithë rrjeti i furnizimit me energji elektrike, rrjeti shpërndarës dhe rrjeti i ndriçimit do të jenë kabllorë. Trasetë e kalimit të tyre do të jenë sipas trotuareve që do të ndërtohen.

5.1.3 Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit

Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit është i projektuar konform kushteve teknike të projektimit për mbrojtjen nga zjarri.

Duke qenë se godinat me rrezikshmëri më të lartë zjarri do të jenë me konstruksion beton armeje dhe muraturë tulle, ato kanë durueshmëri më të lartë nga zjarri. Godinat që do të jenë me konstruksion metalik dhe mure me panele sanduiç do të pajisen me materiale me rezistencë të lartë nga zjarri.

Tubacionet e sistemit hidrik do të jenë zingato dhe me presione punë maksimale prej PFA 20 bar.

Hidrantet do të kenë një rrjetë furnizimi me tuba zingato 2", sipas normave ndërkombëtare bashkëkohore.

Masa shtesë për përmisimin e efikasitetit të sistemit antizjarr do të jenë sistemi automatik i shoqëruar me fikse automatike tavanore, kasetat e hidranteve, fikese zjarri në bombola 9 kg, dyer për dalje emergjence si dhe vendosja e tabelave parandaluese dhe informuese në çdo ambjent pune.

5.1.4 Impianti i shkarkimit të ujrave të zeza

Përsa i përket rrjetit të kanalizimeve ai është parashikuar i ndarë.

Për ujrata e zeza është parashikuar rrjet më vete, i cili nëpërmjet një sistemi tubacionesh e pusetash kontrolli të vendosura në aksin e rrugëve do të lidhet me një gropë septike, të vendosur në zonën jugore të fabrikës. Gropa septike është kompozuar e mbyllur dhe nëntokësore. Ajrimi i gropës me ambientin e jashtëm do të bëhet nëpërmjet një filtri special për heqjen e erës së keqe.

Tubacionet, që do të përdoren janë parashikuar polietileni të brinjëzuar, të cilët do të vihen në kanal jo më pak se 1,5 m thellësi dhe të mbuluar me rërë deri 20 cm mbi tubacionet, diferenca do të mbushet me zhavorr.

5.1.5 Impianti i furnizimit me ujë

Sistemi i furnizimit me ujë brenda impantit është parashikuar unazor i ndërtuar me tuba polietileni me presion deri 10 atm, pajisur me matës për çdo nën-objekt. Sipas kushteve teknike janë parashikuar vendosja e hidranteve të brendshëm dhe hidranteve të jashtëm me presion për shuarjen e zjarrit.

Furnizimi me ujë është parashikuar me pus çpimi me rezervuar qendror, sistem klorimi automatik për dizifektim dhe sistem pompimi për të gjithë fabrikën duke siguruar presionin e nevojshëm dhe furnizimin me ujë 24 orë.

5.1.6 Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut

Largimi i ujrave të shiut është parashikuar i ndarë nga ujrat e zeza me tubacione polietileni të brinjëzuar me sistem pusetash kontrolli dhe sistemin e zgarave.

Ujrat e shiut nuk do të kalojnë në gropen septike por në një kolektor kryesor me anë të të cilit do të largohen deri në përrua.

5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta

Megjithëse impakti në mjedis do të jetë minimal, shoqëria do të realizojë sistemimin e sheshit pas ndërtimit të objekteve dhe rehabilitimin e hapësirave boshe.

Gjithashtu ajo do të krijojë hapësira të gjelbëruara për të vitalizuar dhe për të bërë më këndshëm ambientin e punës.

Në të njëjtën kohë, pemët ekzistuese që ndodhen në territor, do të ruhen në pjesën më të madhe, por njëkohësisht dhe do të ri-mbillen.

6 Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndërtimit

Ndërtimi i impantit të përpunimit të rërave bituminoze do të realizohet në një fazë, pa ndërprerje punimesh. Bazuar në objektivin e projektit investimi do të përballojë volumet kryesore të punimeve si në vijim:

- ✓ Punime për shtrimin e rrugës lidhëse për në kantier;
- ✓ Punime për hapjen, rrethimin dhe sistemimin e kantierit të ndërtimit;
- ✓ Punime për furnizimin me ujë dhe energji elektrike të kantierit;
- ✓ Punime për shtrimin e rrjeteve nëntokësore të linjave të ujesjellësit, kanalizimeve, mbrojtjes nga zjarri, elektrike, etj;
- ✓ Punime për sistemimin e rrugëve të brendshme të kantierit;
- ✓ Punime për ndërtimin e themeleve të godinave të impantit;

- ✓ Punime për ndërtimin e mureve dhe mbulesave të godinave;
- ✓ Punime për instalimet e brendshme të godinave;

Punime për rifiniturat e godinave;

- Punime për sistemimet e jashtme dhe arredimin e gjelbërimit;
- Punimet e paparashikuara.

7. Relacionin e menaxhimit të inerteve të dalta si rezultat i punimeve, që do të kryhen për realizimin e projektit.

Inertet e gjeneruara nga ndërtimi i godinave brenda impiantit do të përdoren brenda territorit të tij, për nivelimin e sistemeve të jashtme. Inertet do të gjenerohen nga proceset e mëposhtme:

- ✓ Pastrimi i kantierit nga shkurret dhe bimësia e nevojshme;
- ✓ Punime dheu për skarifikim, sistemim të disniveleve të ndryshme;
- ✓ Gërmime për baza dhe themele;
- ✓ Mbushje rreth strukturave të reja, etj.

8. Impaktet Kryesore në Mjedis

8.1 Impakt mbi sipërfaqen e tokës

Ky projekt do të ketë fillimisht impakt të përkohshëm në sipërfaqen e tokës, vetëm gjatë fazës së ndërtimit por, me masat që janë marë ky efekt do të eliminohet.

8.2 Impakt mbi ujërat sipërfaqësore

Ky projekt nuk do të ketë impakt mbi ujërat sipërfaqësore pasi gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të objektit nuk do të ndikojmë mbi ndonjë rrjedhë ujore sipërfaqësore. Ujërat që do të dalin nga impianti do të trajtohen dhe më pas do të derdhen në përrua. Impianti do të ndërtohet në një kodër të butë nga pikpamja gjeomorfologjike dhe nuk prek asnjë rrjedhë ujore.

8.3 Impakt mbi ujërat nëntokësore

Nuk do të kemi impakt mbi ujërat nëntokësore. Kjo zonë karakterizohet si e varfër nga pikpamja e ujërave nëntokësore dhe me shtresa ujëmbajtëse relativisht të thella. Në këto kushte themelet e ndërtesave do të jenë relativisht të cekëta dhe nuk do të ndikojnë në këto shtresa ujëmbajtëse.

8.4 Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)

Ky projekt nuk do të ketë impakt negativ mbi Biodiversitetin (Floren, Faunen, Habitatet, Pyjet, etj) pasi zona në të cilën do të ndërtohet impianti nuk është e pasur me resurse të tilla.

8.5 Impakt mbi menaxhimin e tokës dhe mbetjeve

Ky projekt ka parashikuar investimet e duhura për menaxhimin e tokës dhe të mbetjeve dhe si rrjedhojë impakti në këtë drejtim do të jetë shumë minimal. Këto masa janë parashikuar si gjatë fazës së ndërtimit të impiantit ashtu edhe gjatë fazës së funksionimit të tij.

8.6 Impakt mbi Peizazhin

Impakti mbi peisazhin do të jetë minimal sepse në zonën ku do të ndërtohet impianti koeficienti ndërtimor do të jetë i vogël dhe një pjesë e mirë e zonës do të gjelbërohet.

8.7 Impakt mbi Zhurmat dhe ajrin

Impakti mbi zhurmat dhe ajrin do të jetë minimal sepse impianti dhe të gjitha objektet që e përbëjnë atë janë projektuar me standarde të larta, duke respektuar në mënyrë rigoroz normat e lejuara të ndotjes së ajrit dhe për zhurmat.

8.9 Impakt mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë

Zona në të cilën do të ndërtohet impianti nuk ka në brendësi të saj ndonjë objekt me rëndësi arkeologjike dhe kulturore dhe si rrjedhojë nuk do të kemi impakt nga kjo pikëpamje.

9. Aneke (Hartat në format A3)

1. Pamje volumore e impiantit të përpunimit të rërave bituminoze.
2. Harta me kufijtë e pronës ku do të ndërtohet impianti.
3. Harta topografike e zonës së impiantit.

Harta topografike





